



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**V E N D I M**

**Nr. 181, datë 09.04.2024**

**PËR**

**PEZULLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR NR. 3/2024, TË FILLUAR NDAJ  
MAGJISTRATIT, Z. {...}, ME FUNKSION GJYQATAR PRANË GJYKATËS SË  
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 09.04.2024, mori në shqyrtim aktet e procedimit disiplinor nr. 3/2024 që i përket:

**KËRKUES:** Inspektori i Lartë i Drejtësisë

**SUBJEKT I PROCEDIMIT:** Magjistrati {...}

**OBJEKTI I KËRKESËS:**

1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë
2. Propozimin për caktimin e masës disiplinore :  
- “Shkarkim nga detyra”

**BAZA LIGJORE:** Neni 138; neni 102, pika 1, shkronja “a” dhe “p”; neni 103, shkronja “b”; neni 105, pika 1, shkronja “dh”; neni 111 i Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në seancë dëgjimore, pas shqyrtimit të çështjes sipas parashikimeve të nenit 142 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi propozimin e relatorit z. Ridvan Hado, Këshilli

**V Ë R E N:**

1. Më datë 15.02.2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. 161/34 prot., datë 15.02.2024, ka depozituar për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesën me objekt *Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.*

2. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016, "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar, dhe në nenin 138 të Ligjit nr. 96/2016, "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga nenet 102, pika 1, shkronja "a" dhe "p", neni 103, shkronja "b" të Ligjit nr. 96/2016.

3. Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës disiplinore "Shkarkim nga detyra" ndaj magjistratit z. {...} të parashikuar nga nenet 105, pika 1, shkronja *dh* dhe 111 të Ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

## **I. FAKTET DHE RRETHANAT E PRETENDUARA OBJEKT TË PROCEDIMIT DISIPLINOR**

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në analizë të pamjeve të videove të publikuara më datë 15.01.2024 në median e shkruar dhe atë vizive, ku është publikuar një video e realizuar nga emisioni investigativ "STOP" Televizioni "Klan", me titull "Gjyqtari i Vlorës jep zyra me qira dhe shet gjyqe"<sup>1</sup>, ka konstatuar se magjistrati {...} me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është filmuar në bisedime më një person tjetër, të pidentifikuar, objekt i të cilës është marrja me qira, e një ambienti zyrë, në pronësi të gjyqtarit.

5. Referuar përmbajtjes së kësaj video ka rezultuar se veprimet e kryera nga gjyqtari {...} dhe deklaratimet e këtij të fundit lidhen me mundësinë e dhënies më qira të ambientit dhe lehtësimet ligjore procedurale që ky gjyqtar mund të krijojë për palën qiramarrëse edhe në proceset e ndryshme gjyqësore.

5.1 Në faqen ëeb të televizionit Klan<sup>2</sup>, është publikuar në mënyrë të shkruar transkriptimi i përmbajtjes së videos, si më poshtë:

I infiltuari: Z. {...} *si kaluat? Si jeni?*

Gjyqtari {...}: *Mirë, faleminderit!*

---

<sup>1</sup> <https://tvklan.al/stop-gjyqtari-i-vlores-jep-zyra-me-qira-dhe-shet-gjyqe/>

<sup>2</sup> Po aty

I infiltuari: *U interesova dhe më thanë, nusja në fakt ka mbaruar për psikologji, iku tek zyra, që ka pasur diku tek Trans Ballkanikja dhe thamë mos gjenim ndonjë vend këtu afër.*

Gjyqtari {...}: *Ka qënë ndonjë herë në gjyq tek unë?*

I infiltuari: *Jo, jo...! Ta shikoj njëherë si ambient vëlla dhe...?*

Gjyqtari {...}: *Ja shikoje si zyrat e shtetit, po është mirë këtu, se është afër me gjykatën.*

I infiltuari: *Prandaj e doja këtu afër!*

Gjyqtari {...}: *Zyrat janë të freskëta në behar, të ngrohta në dimër.*

I infiltuari: *Kështu është e mobiluar?*

Gjyqtari {...}: *Po, po! Ky është ambienti, është super komod dhe është lirë, 100 mijë lekë...*

I infiltuari: *Tek 100 mijë lekshi e ke?*

Gjyqtari {...}: *Po, paguaj energjinë vetë se e kam me një sahat, plus tsaksën e qirasë, se më lirë, s'ka...*

I infiltuari: *Tani unë do të le një farë kapari. Mua po më pëlqen si ambient, nuk dua ta lëshoj!*

Gjyqtari {...}: *Po më ke dhënë tepër... është me 106.*

I infiltuari: *S'ka gjë! Mbaj! Brënda mundësive gjithmonë, meqë mund të dalim të njohur më vonë, jo e kisha tek kjo pjesë, mund të na ndihmosh me ndonjë gjyq, n.q.s të jepet mundësia?*

Gjyqtari {...}: *Ore ata avokatët, që janë, këtu zëre, se janë pa qira fare. Ju them unë paguaj energjinë elektrike, se e kam sahatin për të gjithë godinën, se punon dhe zonja ime këtu, ka një After school dhe ju them unë, që energjinë e paguaj, në gjyqe ju marr, ja u paguaj edhe qiranë... zëre se e kanë pa lekë fare... I.*

5.2 Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në analizë të përmbajtjes së komunikimit ndërmjet magjistratit {...} dhe personit të infiltuar, nga ana e emisionit investigativ “STOP”, rezulton në pamje të parë që magjistrati, duke shfrytëzuar pozicionin e tij të punës si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, garanton jo vetëm personin, i cili është i interesuar për të marrë me qira ambientet në pronësi të tij, por edhe subjekte të tjera, të cilat kanë tashmë një marrëdhënie të posaçme biznesi me të, si avokatë apo ekspertë, të cilët shpërblehen nga ana e tij duke i angazhuar në procese të ndryshme gjyqësore, të cilat drejtohen prej tij.

6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të parimit të ligjshmërisë, si organ kompetent në ushtrim të funksioneve të tij ligjore, ka analizuar përmbajtjen e sjelljeve të magjistratit të publikuara në media, me qëllim identifikimin e elementëve juridik, si dhe fakteve apo rrethanave, të cilat në bazë të një dyshimi të arsyeshëm justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor.

6.1 Në rastin konkret, sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dyshimi i arsyeshëm nënkupton ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit të shqyrtuara e vlerësuara në tërësi, të cilat në bazë të një gjendje të logjikshme dhe të

paanshme, i krijojnë bindjen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi ekzistencën e një veprimi/mosveprimi apo sjellje të magjistratit e cila parashikohet si shkelje disiplinore nga ligji në kohën e kryerjes së saj si dhe në kohën e konstatimit të saj, shkelja disiplinore mund të jetë kryer dhe se kjo shkelje është kryer nga magjistrati ndaj të cilit do të nisë hetimi disiplinor.

6.2 Sa sipër, rezulton se plotësohen kriteret e parashikuara nga neni 120 dhe 124<sup>3</sup> të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilat justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit {...}, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

7. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duke vlerësuar në analizë të fakteve të konstatuara, në rastin konkret, ekzistojnë *dyshime të arsyeshme* të bazuara nga informacioni, të dhënat e përfutuara nga media, se magjistrati {...}, mund të ketë ushtruar detyrat e tij në kushtet e konfliktit të interesit në kundërshtim me parashikimet e Ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

7.1 Në këtë kuadër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraprakisht ka vlerësuar se për sa kohë që veprimtaria e zyrtarit (magjistratit) në këtë rast, e cila pretendohet se prodhon një situatë papajtueshmërie apo konflikti i interesit, lidhet me veprimtarinë gjyqësore të tij, dispozitat e Ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, duhet të analizohen dhe të zbatohen në mënyrë të bashkërenduar dhe sistematike me parashikimet e Ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas rregullave të parashikuara në pikën 3 dhe 4, të nenit 5 të Ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.<sup>4</sup>

---

<sup>3</sup> Neni 124 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se : “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh”.”

<sup>4</sup> Në pikën 3 dhe 4, të nenit 5, të Ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “...[...].2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë. 3. Nëse në këtë ligj, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për këtë ligj dhe anasjelltas 4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i një zyrtari nga ata

7.2 Për sa më sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në kushtet kur, në rastin konkret duhet të analizoheshin kryesisht të gjitha faktet, si dhe duhet të vlerësoheshin të gjitha rrethanat e nevojshme, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 161/1 prot., datë 16.01.2024, “Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”, ka nisur hetimin ndaj magjistratit {...}, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102/1, shkronja “a” dhe “p” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet shprehimisht se: *“Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë: (a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas Ligjit, nëse magjistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tilla; ...[...](p) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi”, si dhe nga neni 103 shkronjat “a” dhe “b” ku parashikohet: Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë: a) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë me funksionin e magjistratit ose të kufizimeve për shkak të funksionit, sipas parashikimeve të bëra në nenet 6 dhe 7, të këtij ligji; ...[...]. b) përdorimi i statusit të magjistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët.*

8. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur në shkelje disiplinore, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, nën udhëheqjen e parimit të ligjshmërisë. Në të njëjtën kohë, gjatë procesit hetimor duhet të analizohen një sërë çështjesh të cilët kanë të bëjnë me: (i) identifikimin e elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë, ekzistencën e shkeljes disiplinore, si dhe nuk diktojnë mbylljen e hetimit disiplinor; (ii) identifikimin e elementeve faktikë dhe juridikë mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratit subjekt hetimi disiplinor; (iii) identifikimin e elementeve faktikë dhe juridikë që justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor.

9. Në analizë të identifikimit të elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë, ekzistencën e shkeljes disiplinore, si dhe nuk diktojnë mbylljen e hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nga analiza e provave të administruara në kuadër të këtij procesi hetimor, ka konkluduar se në rastin konkret nuk ekziston asnjë rrethanë faktike apo element juridik, i cili dikton mbylljen e këtij hetimi disiplinor në mbështetje të parashikimeve të nenit 117, nenit 120, pika 1, shkronja “b”, “ç”, “d”, “dh”, nenit 134, pika

---

*të përcaktuar në këtë nen, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi...[...]*”

1, shkronja “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

10. Për sa i përket ekzistencës së shkeljes që ka ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor referuar nenit 117 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se shkelja e pretenduar ka ndodhur brenda afatit 5 vjeçar të parashkrimit të shkeljes disiplinore, pasi rezulton se pamjet janë publikuar në median e shkruar dhe atë vizive, nga emisioni investigativ “STOP” Televizioni “Klan” në datën 15.01.2024, ndërsa magjistrati {...}, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

11. Magjistrati subjekt hetimi disiplinor z. {...} ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur. Ai gëzon statusin e magjistratit edhe në kohën e fillimit të hetimit disiplinor, si dhe vazhdon të ruajë statusin e magjistratit për efekt të çdo procedimi disiplinor, në rastet e vërtetimit të një shkelje me pasojë përgjegjësinë disiplinore të magjistratit të parashikuar në nenet 102-104 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë nuk ekzistojnë elementë për mbylljen e hetimit disiplinor për shkak statusi referuar nenit 134 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

11.1 Ndërkohë ekzistojnë elemente juridik dhe faktik për mbylljen e hetimit disiplinor për shkeljen disiplinore parashikuar nga neni 103 shkronja “a” e Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore sipas nenit 134 pika 1 shkronja “a”.

12. Për sa i përket identifikimit të elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë, ekzistencën e shkeljes disiplinore nga ligji në kohën e kryerjes së saj, si dhe në kohën e konstatimit të saj, nëse provohet kryerja e veprimeve/mosveprimeve nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor ato përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronjat “a”, “p”, neni 103 shkronjat “a” dhe “b” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

13. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, mbi të dhënat e administruara në funksion të hetimit disiplinor, ka konkluduar se nuk rezulton që shkeljet objekt hetimi disiplinor të jenë hetuar më parë apo të jetë përfunduar me një vendim respektiv, për rrjedhojë nuk ekzistojnë elementë për mbylljen e hetimit disiplinor për këtë shkak, referuar nenit 134 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

14. Nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në analizë të çështjes se nëse nga ana e magjistratit, subjekt hetimi disiplinor janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tij profesionale, theksohet se në mbështetje të nenit 101, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet nëse veprimi apo mosveprimi i magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merren parasysh një sërë faktorësh si: (a) shkalla e pakujdesisë (fajësisë); (b) shpeshtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes; (c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem; (ç) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; (d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.

15. Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara si dhe nga dokumentacioni i administruar provohet se veprimet/mosveprimet e magjistratit nuk janë të lidhura vetëm me veprimtarinë e tij profesionale, por dukshëm ato përbëjnë shkelje disiplinore.

16. Nga veprimet hetimore të kryera dhe provat e mbledhura në funksion të hetimit disiplinor, ka rezultuar se në datën 15.01.2024 në median e shkruar dhe atë vizive, është publikuar një video e realizuar nga emisioni investigativ “STOP” Televizioni “Klan”, ku gjyqtari {...}, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është filmuar në bisedime me një person tjetër, të paidentifikuar, objekt i të cilës është marrja me qira e një ambienti zyre në pronësi të gjyqtarit.

16.1 Referuar përmbajtjes së kësaj video rezulton se veprimet e kryera nga gjyqtari {...} dhe deklaratimet e këtij të fundit lidhen me mundësinë e dhënies me qira të ambientit dhe lehtësimet ligjore procedurale që ky gjyqtar mund të krijojë për palën qiramarrëse edhe në proceset e ndryshme gjyqësore. Në analizë të përmbajtjes së komunikimit ndërmjet magjistratit {...} dhe personit të infiltuar nga ana e emisionit investigativ “STOP”, rezulton në pamje të parë që z. {...}, duke shfrytëzuar pozicionin e tij të punës si magjistrat pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, garanton jo vetëm personin, i cili është i interesuar për të marrë me qira ambientet në pronësi të tij, por shpjegon se edhe subjekte të tjera avokat apo ekspertë të cilët janë qirramarës në godinën ku ai është pronar “zëre se janë pa qira fare” kjo për shkak dhe të interesimit të vetë gjyqtarit duke i angazhuar në procese të ndryshme gjyqësore, të cilat drejtohen prej tij.

16.2 Po ashtu, në deklaratimet e tij, gjyqtari {...} subjekt hetimi disiplinor, ka pranuar se është ai personi që shfaqet në video, ku është shprehur se *duke qenë gjithmonë i sinqertë dhe i vërtetë dhe pasi kam paraqitur më datë 05.01.2024 deklaratën për heqje dorë, edhe pse dihet se është e parevokueshme dhe përgjimi ka ndodhur në datë 12, unë nuk mohoj që kisha interesa si bashkëpronar të jepja zyrë me qira, dhe kjo ishte ndihmë për bashkëshorten e*

*cila e administronte dhe ishte qiradhënëse dhe nuk përbën ndonjë shkelje të etikës fakti që unë interesohem të reklamoj se kjo gjë është me përfitime se është afër gjykatës, pasi mund të kenë më shumë procese gjyqësore, por kjo nuk do të thotë që këto procese do t'i bënin me mua, për çështje përfitimi, pasi unë nuk do të isha më gjyqtar pas pak kohe.*

16.3 Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga aktet e administruara, nuk ka rezultuar kërkesë për dorëheqje e magjistratit e formalizuar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Referuar Ligjit 96/2016 “Për Statusin”, në nenin 65 pika 1 përcaktohet: “Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës”. Ndërsa pika 2 përcakton se: “Dorëheqja jep efektet ....., nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes”.

16.4 I pyetur lidhur me subjektet qiramarrëse, magjistrati ka deklaruar se: “Në këto ambiente janë me qira subjekte përgjithësisht ekspert dhe avokat. Kontratat me to janë nënshkruar nga ana e bashkëshortes time.. Subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet janë të regjistruara në organet tatimore, dhe paguajnë detyrimin tatimor në burim, nga ana e qiramarrësit, ndërkohë kontratat e qirasë i kam të noterizuara.” Në lidhje me pjesëmarrjen në procese gjyqësore të qiramarrësve gjyqtari {...} është shprehur se: “Po ka të tilla që mund të kenë marrë pjesë, por nuk përbën konflikt interesi apo detyrim për heqje dorë, pasi nuk ka marrëdhënie interesi mes palëve, pasi kjo pronë administrohet nga bashkëshortja ime, dhe marrëdhënia e qirasë nuk është e tillë që të konsiderohet marrëdhënie interesi në kuptim të Ligjit. Neni 72 dhe 73 i K. Pr. Civile. Ndalohet vetëm kontrata e kredisë. Ligji nuk e njeh kontratën e qirasë si rast të konfliktit të interesit..... Subjektet të cilat ushtrojnë aktivitetin si avokat dhe ekspert, janë thirrur, por sipas Ligjit, për nevoja të gjykatës, por nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi edhe kontrata e qirasë nuk është bërë me mua.” Dhe se dhe sikur të isha i veshur gjyqtar, do të duhej të interesohesha pa qëllim përfitimi si gjyqtar, të reklamoja që këto zyra janë në shërbim të bashkëpronares time, bashkëshortes time, pasi në kapitalizëm nuk është e ndaluar fitimi financiar.

16.5 Ndërkohë, i pyetur lidhur me subjektet qiramarrëse në këto ambiente shërbimi, magjistrati është përgjigjur duke dhënë këto emra: {...} Avokate, {...} Avokat, {...} Avokat, {...} Avokat, {...} Avokat, {...} Avokat, {...} Ekspert.

16.6 Në vijim, në parashtrimet e tij gjyqtari {...} është shprehur: *Unë si gjyqtar nuk kam privilegjuar asnjë psikolog, apo ekspert, apo avokat. I kam thirrur të gjithë, pa privilegjuar ndonjë të veçantë...Në rreth 800-900 çështje në vit, që unë kam patur ngarkesë në gjykim, avokatët apo ekspertët që janë qiramarrës në godinë, janë rezultojnë në gjykime në çështjet kryesisht në fund jave, të shtunë të diel, si dhe në çështje që të pandehurit e mitur, apo të pandehur të tjerë në masat e sigurimit apo seancë paraprake, është e detyrueshme prania e avokatit për mbrojtje të personave pa të ardhura... Kryetari i Dhomës së Avokatisë nuk ka vënë në dispozicion listën e avokatëve të gatshëm. Në këto raste janë aktivizuar punonjës drejtues i policisë së shoqërimit të burgosurve {...} dhe sekretaret gjyqësore. Në disa raste*



*duke qenë godina afër, ka rastisur spontanisht të thirren avokatë qiramarrës në godinë {...}, {...}, {...} dhe psikologe {...} (afër godinës time por jo qiramarrëse). Unë duke mos pasur konflikt interesi me ta, sipas nenit 72 të K.Pr.Civile apo 17 të K.Pr.Penale, pasi nuk jam unë qiradhënësi por bashkëshortja ime {...} {...}, nuk mund t'i refuzoja, aq më tepër kur është në interes të mbarëvajtjes së gjykimit dhe në ndihmë administrativisht dhe procedurialisht. Unë nuk kam patur përfitim. Në shumicën e rasteve avokatët e psikologët nuk e marrin fare dëmshpërblimin 3000 lekë që paguan financa e gjykatës. Unë si gjyqtar nuk kam keqadministruar drejtësinë si procedurale dhe materiale duke mos pasur përfitime materiale...”*

16.7 Gjithashtu, magjistrati ka parashtruar faktin se si gjyqtar nuk ka pasur marrëdhënie të posaçme biznesi, por bashkëshortja e tij ka qenë në cilësinë e qirradhënëses, duke mos u përmbushur parashikimet e nenit 72 të K.Pr.Civile. Ai thekson se raportet e tij me avokatët apo ekspertët nuk janë të llojit favorizues për shkak të kontratës së qiradhënies me bashkëshorten e tij dhe se numri i çështjeve që ka patur me subjektet qirramarëse është tejet i vogël në proporcion me volumin e punës dhe e papërfillshme për të vënë në dispozicion besueshmërinë e tij si gjyqtar.

17. Nga analizimi i të dhënave të administruara, nga njëra anë gjyqtari subjekt hetimi disiplinor shprehet se kontratat e qiradhënies janë të lidhura dhe administrohen nga bashkëshortja e tij {...} {...}, ndërsa nga ana tjetër e konsideron të drejtë interesimin për aktivitetin e bashkëshortes, madje duke u shprehur se dhe sikur të isha i veshur gjyqtar do të duhej të interesohesha pa qëllim pëfitimi si gjyqtar, të reklamoja që këto zyra janë në shërbim të bashkëpronares time (bashkëshortes) pasi në kapitalizëm nuk është i ndaluar fitimi financiar.

18. Në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, si dhe referuar të dhënave të dërguara nga ILDKPKI për deklarimin periodik vjetor, rezulton se bashkëshortja e gjyqtarit {...} është në cilësinë e personit të lidhur me deklaruesin dhe se të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e zyrave janë pjesë e të ardhurave familjare ku kryefamiljar është z. {...}.

18.1 Në deklarimin “Periodik Vjetor 2022”, z. {...} deklaroi se është pronar i pasurisë të llojit Truall + Ndërtesë, ndodhur në lagjen “Isa Boletini”, Vlorë, e destinuar si ambiente shërbimi, (zyra), për të cilën subjekti deklaroi se shfrytëzohet për aktivitetin tregtar të kopshtit për fëmijë “{...}” me NIPT {...} dhe qiradhënie zyrash, (kati i dytë pjesërisht dhe kati i tretë plotësisht). Të ardhurat që janë gjeneruar nga kontratat e qirasë në pronën e cituar më lart, nuk janë deklaruar në *seksionin e të ardhurave dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private* të subjektit deklarues z. {...}.

18.2 Në cilësinë e bashkëshortes shtetasja znj. {...} {...}, në deklarimin “Periodik Vjetor 2022”, deklaroi se është bashkëpronare në pasurisë të llojit Truall + Ndërtesë, ndodhur në

lagjen “Isa Boletini”, Vlorë. Në deklarinimin e shtetasës {...} {...} në seksionin e të ardhurave dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private të subjektit deklarues znj. {...} {...}, është deklaruar se: “Janë dhënë zyra me qira për qiramarrës të ndryshëm regjistruar si subjekte tregtare dhe ushtrojnë aktivitet Avokatie dhe Zyrë Topografie”. Duke përcaktuar shumat e përfituara, dhe emrat e subjekteve qirramarës shtetasit {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Ndërsa në deklarinimin periodik vjetor 2023 ka shtuar si subjekte qirramarës dhe prej të cilëve ka përfituar të ardhura nga qirraja shtetasit {...}

19. Sipas verifikimit të bërë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në drejtim të verifikimit të gjykimit të çështjeve nga gjyqtari {...} në kushtet e konfliktit të interesit, nga aktet e administruara përgjatë hetimit disiplinor (Vendimet e dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë) ka rezultuar se:

- Në 13 çështje gjyqësore për të cilat gjyqtari {...} ka gjykuar dhe marrë vendime, avokat i njëjës nga palët apo dhe në cilësinë e paditësit ka qenë i pranishëm avokat {...} i cili ushtron funksionin e avokatit me zyrë të marrë me qirra në pronën e paluajtshme ndodhur në lagjen “Isa Boletini” pronë e cila është në bashkëpronësi të vetë gjyqtarit {...}. Këto çështje kanë të bëjnë përkatësisht me vendimet e gjykatës : - nr. 156, datë 17.03.2022; - nr. 518, datë 14.06.2022; - nr. 1431, datë 10.12.2020; - nr. 401, datë 23.05.2023; - nr. 1094 Regj, datë 03.02.2023; - nr. 1644, datë 17.10.2019; - nr. 1103, datë 01.07.2019; - nr. 839, datë 14.09.2020; - nr. 1053, datë 30.06.2021; - nr. 7, datë 11.01.2023; - 32, datë 16.02.2020; - nr. 1225, datë 11.01.2023; - nr. 34, datë 16.02.2020; të cituara më sipër në pikën 28 dhe në pikën 29.1 të raportit.
- Në 1 çështje gjyqësore, gjykuar me Vendimin nr. 620, datë 15.04.2021, në cilësinë e palës paditëse ka qenë {...}, qirramarës në objektin në bashkëpronësi të gjyqtarit {...}, cituar sa më sipër në pikën 28 të raportit.
- Në 5 çështje gjyqësore për të cilat gjyqtari {...} ka gjykuar dhe marrë Vendime, avokat i njëjës nga palët ka qenë avokate {...} e cila ushtron funksionin e avokates me zyrë të marrë me qirra në pronën e paluajtshme ndodhur në lagjen “Isa Boletini” pronë e cila është në bashkëpronësi të vetë gjyqtarit {...}. Këto çështje kanë të bëjnë përkatësisht me Vendimet e gjykatës : - nr. 483, datë 25.10.2023; - nr. 1531, datë 04.10.2019; - nr. 219, datë 12.02.2021; - nr. 1264, datë 17.11.2020; - nr. 594, datë 14.04.2021, të cituara sa më sipër në pikën 28 të raportit.
- Në një çështje gjyqësore, gjykuar me Vendimin nr. 350, datë 13.10.2022, në cilësinë e përfaqësuesit të të pandehurit ka qenë avokat {...}, qirramarës në objektin në bashkëpronësi të gjyqtarit {...}.

19.1 Ligji nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshua, është një ligj kuadër, i cili ka për qëllim garantimin e një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta. Objekti

i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

19.2 Në mbështetje të nenit 3, pika 1, të Ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, “*Konflikt i interesit*” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike. Konflikti i interesit, përfshin disa lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si: (i) konflikt faktik i interesit; (ii) konflikt në dukje i interesit; (iii) konflikt i mundshëm i interesit; (iv) konflikt rast për rast i interesit; (v) konflikt i vazhdueshëm i interesit.<sup>5</sup>

19.3 Kryerja në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive, është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit. Ndërkohë, kryerja në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive është rasti kur nuk plotësohet të paktën njëra prej këtyre kërkesave për shkak dhe vetëm të ndikimit të mundshëm të interesave privatë të zyrtarit.<sup>6</sup>

19.4 Nga ana tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë argumenton se për sa kohë që konflikti i interesit është *gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë* të një zyrtari, në rastin konkret duhet të analizohen një sërë elementësh faktikë dhe juridikë në lidhje me ekzistencën e *interesit privat* sipas kërkesave të nenit 5, pika 1, të Ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

---

<sup>5</sup> Neni 3, pika 4 e Ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, parashikon se : “4. *Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë: a) “konflikt faktik i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare; b) “konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë; c) “konflikt i mundshëm i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara; ç) “konflikt rast për rast i interesit” është gjendja me konflikt interesi, në njërin nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një Vendimmarrje të veçantë; d) “konflikt i vazhdueshëm i interesit” është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshë në të ardhmen.”.*

<sup>6</sup> Neni 3, pika 2 dhe pika 3 e Ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

i ndryshuar<sup>7</sup>, i cili parashikon në mënyrë shteruese rrethanat se nga mund të burojnë, përputhen, përmbahen apo bazohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë interesat private. Ndërkohë, Ligji nr. 9367/2005 në Kreun III, seksioni 1 dhe Seksioni 2, për disa çështje të veçanta, ka trajtuar në detaje ndalime dhe kufizime për sa i përket rrethanave, rasteve, llojit të interesit privat, apo subjekteve (funksioneve publike) që synojnë parandalimin e rënies së zyrtarëve publikë në konflikt rast për rast të interesit.

19.5 Marrëdhënia kontraktuale e qirradhënies së bashkëshortes së gjyqtarit {...}, me avokatët të cilët ushtrojnë funksionin në zyrat të cilat janë në bashkëpronësi të gjyqtarit dhe bashkëshortes së tij, është një marrëdhënie e cila, bazuar në përcaktimin e nenit 5, pika 1 e Ligjit nr. 9376, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, klasifikohet si konflikt interesi i ardhur prej një marrëdhënieje juridiko-civile me të drejta dhe detyrime reciproke, marrëdhënie kjo e njohur mes palëve.

19.6 Në analizë të dispozitave ligjore të cilat parashikojnë rregulla në lidhje me ushtrimin e detyrës në mënyrë të paanshme dhe jo në kushtet e konfliktit të interesit, vlerësohet se, pavarësisht se gjyqtari nuk gjendet në situatat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile nga neni 72, pikat nga 1 deri 5 të tij si dhe në Kodin e Procedurës Penale neni 17 pika 1 shkronjat “a” deri në “e”, mbetet për t’u vlerësuar zbatimi i pikës 6 të nenit 72 të K.Pr.Civile, e cila parashikon rastin se gjyqtari detyrohet të dorëhiqet në rast se ekzistojnë arsye serioze njëanshmërie, si dhe zbatimi i pikës 1 shkronja “ë” të nenit 17 K.Pr.Penale e cila parashikon se gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.

19.7 Në këto kushte çmohet se analiza e kësaj situatë bëhet mbi vlerësime të testit objektiv e subjektiv, duke qenë se situata në vetvete nuk përfaqëson një nga rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji. Në konsideratë të vlerësimit të testit objektiv, vlerësohet se natyra e marrëdhënies juridiko civile që bashkëshortja e gjyqtarit {...} kishte me avokatët të cilët kanë marrë pjesë si palë/përfaqësues të tyre në procese gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari {...}, pasi dhe të ardhurat e përfitura nga qirraja janë pjesë e përbashkët e ekonomisë

---

<sup>7</sup> Neni 5 (Interesat private) i Ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. *Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; ç) negociime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negociime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës; d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër; dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; ii) të komunitetit; iii) etnike; iv) fetare; v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë; e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni...[...]*”.

familjare dhe në këto kushte, duket se e vënë në diskutim nga syri i një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm, paanësinë e gjyqtarit në gjykimin e çështjeve gjyqësore.

19.8 Në këtë kuptim, pavarësisht parashtrimeve të gjyqtarit se ai kapërcente testin e kriterit subjektiv sepse nuk ndihej i njëanshëm në gjykimin e çështjes, vlerësohet se mjaftojnë rrethanat objektive për ta stimuluar te gjyqtari një reagim në drejtim të garantimit jo vetëm të paanësisë së tij, por edhe të parimit se drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe të duket se jepet.

19.9 Në këtë drejtim, nga një vlerësim në tërësi i çështjeve gjyqësore, konstatohen rastet që subjekti nuk ka vepruar për të shmangur situata të konfliktit faktik të interesit apo atij në dukje, porë kjo edhe me rëndësinë që ka besimi dhe perceptimi i publikut në pavarësinë, etikën, integritetin dhe paanshmërinë që magjistrati duhet të kujdeset të reflektojë. Ky detyrim, përveç se gjen rregullim specifik në dispozitat përkatëse të kreut V të Kodit të Procedurës Civile apo Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjin nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ka gjetur vend edhe në Ligjin e posaçëm nr. 96/2016, Për statusin e magjistratëve, nenet 3, 4 e në vijim të tij.

19.9.1 Për sa më sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë argumenton se jo në të gjitha rastet subjekti është kujdesur për shmangien e konfliktit të interesit faktik dhe atij në dukje. Raste në të cilat, në pamje të parë, më së paku do të paragjykonin paanshmërinë e vendimmarrjes, pasi në to ndërthuret gjykimi i subjektit gjatë procedurave gjyqësore, me vendimmarrjet apo ndikimet e mundshme, të drejtpërdrejta apo të tërthorta për shkak të marrëdhënies, të personit të lidhur me të, bashkëshortes. Një situatë e tillë eventualisht mund të minojë besimin që gjykatat duhet të frymëzojnë te shoqëria dhe publiku.

19.10 Gjykata Kushtetuese në Vendimin nr. 16, datë 11.11.2004, ndër të tjera, ka arsyetuar: *[...] Në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, personi i zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesat e ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo Vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizikë dhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike [...].*

19.11 Gjithashtu në Komentarin e Parimeve të Bangalores, në pikën 52 të saj parashikohet se: *Paanshmëria është cilësia themelore e kërkuar nga një gjyqtar dhe atributi kryesor i gjyqësorit. Paanshmëria duhet të ekzistojë edhe si çështje faktike, edhe si çështje e perceptimit të arsyeshëm. Nëse njëanshmëria perceptohet në mënyrë të arsyeshme, ky perceptim ka të ngjarë të lërë një ndjenjë ankese dhe padrejtësie që është kryer, duke shkatërruar kështu besimin në sistemin gjyqësor. Perceptimi i paanshmërisë matet me standardin e një vëzhguesi të arsyeshëm. Perceptimi se një gjyqtar nuk është i paanshëm*

*mund të lindë në një numër mënyrash, përshembull, nga një konflikt interesi i perceptuar, nga sjellja e gjyqtarit në gjykatë, ose nga lidhjet dhe aktivitetet e tij jashtë gjyqësore [...].*

19.12 Në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 29.04.2010, citohet se: *Për Gjykatën, është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili, në këndvështrimin objektiv, nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Duke u bazuar gjithashtu në rezolutën me 10 parimet bazë të miratuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, lidhur me parimin e paanësisë shprehet: Gjyqtarët duhet që të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme duke e garantuar dhe evidentuar paanshmërinë. Ata duhet të kujdesen që të shmangin në çdo rast konfliktin e interesit, por edhe përzjerjen në të gjitha ato situata të cilat perceptohet se e përfshijnë apo krijojnë për gjyqtarët konflikt interesi. Lidhur me paanshmërinë, gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri të plotë, si dhe të garantojnë aparencën e paanshmërisë.*

19.13 Inspektori i Lartë i Drejtësisë argumenton, për sa më sipër, se gjyqtari {...} nuk ka treguar kujdesin e duhur për të vlerësuar me objektivitet, mundësinë e dorëheqjes nga këto procese gjyqësore për të shmangur çdo dyshim për paanësinë e tij në gjykimin e tyre, sipas një vlerësimi të një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm. Në çështjet gjyqësore të trajtuara më lart, konkludohet se gjyqtari nuk ka treguar kujdesin e duhur në raport me vlerësimin e konfliktit të interesit dhe shmangies së tij nëpërmjet dorëheqjes nga këto çështje, si edhe në papajtueshmëri me parimet e Bangalores për sjelljen e gjyqtarit<sup>8</sup>.

19.14 Në këto kushte, referuar përmbajtjes së pikës 2 të nenit 5 të Ligjit nr. 9376/2005, e cila përcakton se: *Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër (në këtë rast nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe neni 17 Kodi i Procedurës Penale), sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë, vlerësohet se gjyqtari duke mos hequr dorë nga gjykimi i çështjeve gjyqësore ku bashkëshortja e tij është në marrëdhënie juridiko civile me avokatët përfaqësues të palëve në këto procese, ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe të papajtueshmërisë së funksionit.*

19.14.1 Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, më së shumti ky argument përforcohet dhe me faktin së është vetë gjyqtari {...} i cili në datën 13.02.2024, i është drejtuar zv/kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me kërkesën për “Heqje dorë nga gjykimi”, në çështjen

---

<sup>8</sup> Parimet e Bangalores përcaktojnë standarde të njohura ndërkombëtarisht për sjelljen gjyqësore, të miratuara nga Grupi Gjyqësor për Forcimin e Integritetit Gjyqësor (2002), te të cilat, lidhur me parimin e paanshmërisë së gjyqtarit, ndër të tjera, në pikën 2, paragrafi 2.5, përcaktohet se :“2.5 Gjyqtari duhet të përjashtojë veten nga pjesëmarrja në çdo procedurë në të cilën ai nuk është në gjendje ta gjykojë atë në mënyrë të paanshme ose në të cilën për një vëzhgues të arsyeshëm mund të duket se gjyqtari nuk është në gjendje të gjykojë e vendosë në mënyrë të paanshme. Procedura të tilla përfshijnë, por nuk kufizohen në, rastet e listuara në këtë dispozitë të parimeve të Bangalores”.

(Shih: [https://ëëë.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial\\_group/Bangalore\\_principles.pdf](https://ëëë.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf).)

me palë kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, të pandehur {...} etj..., akuzuar për veprat penale “Mashttrim me pasoja të rënda” si dhe “Falsifikimi i vulave i stampave ose i formularëve...”

Ndër të tjera magjistrati në kërkesën e tij, sqaron se: *Ju bëjë me dije se nga përfaqësuesit e viktimave {...} si dhe avokatet e tyre {...} është ngritur pretendimi se Avokati i të pandehurve {...}, është në konflikt interesi me Gjyqtarin {...}, pasi bashkëshortia e Gjyqtarit Znj. {...} {...}, është palë në Kontratën e Qirasë nr. 1201 rep, nr. 536 kol datë 05.07.2023, ku qiradhënës është Avokati {...} (Ndërkohë avokati është në cilësinë e palës qiramërrëse).*

Në kërkesën drejtuar Zv. Kryetarit të Gjykatës, z. {...}, ndër të tjera magjistrati {...}, deklaron se: *Konstatohet pengesë ligjore: Neni 17 “Heqja dorë”. Nga ana ime si gjyqtar duhet të gjykohet vetëm një çështje penale dhe pikërisht kjo çështje që është regjistruar me pas administrativisht. Megjithëse Avokati {...} nuk rezulton të jetë debitor apo të ketë një mosmarrëveshje të tillë për shkak të Kontratës së Qirasë, mendoj se është mundësia e lindjes se mosmarrëveshjes dhe duhet të zbatohet neni 17, gërma e “kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”. Bashkëngjitur kësaj kërkesë ndodhet Kontrata e Qirasë nr. 1201 rep, nr. 536 kol datë 05.07.2023 ku qiradhënës (qiramarrës në fakt) është avokati {...}*

19.14.2. Me Vendimin datë 13.02.2024 “Për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje”, Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka vendosur “Pranimin e kërkesës për dorëheqje të gjyqtarit z. {...} nga gjykimi i çështjes penale me nr. 429 regj. Them., datë regjistrimi 25.04.2023...”. Në marrjen e këtij Vendimi zv/Kryetari i gjykatës z. {...}, ndër të tjera ka interpretuar: “Duke analizuar shkaqet e paraqitura dhe parashikimin e dispozitës Neni 17/1/ë i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se “1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a) kur ka interes në procedim ose ku një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij.”, si dhe Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 3 parashikon se: “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim: 1. “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari në të cilën ai ka interea privatë, të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike....”, çmos se kërkesa e paraqitur nga ana e Gjyqtarit z. {...}, ka shkaqe të përlegjura për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështje, pasi A. {...}, ka një kontratë qiraje me bashkëshorten e gjyqtarit, pra bashkëshortja e gjyqtarit është qiradhënëse (kreditore) dhe Avokati {...} është qiramarrës (debitor) sipas përcaktimeve të nenit 17 pika 1, gërma a. Gjithashtu me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor dhe gjykimin nga një gjykatë e paanshme jo vetëm në qenie por edhe në dukje, vlerësoj se kërkesa për heqje dorë duhet të pranohet pasi marrëdhënia kontraktore e qirasë në dukje duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive publike të gjyqtarit, sipas përcaktimeve të nenit 3 të Ligjit 9367, datë 07.04.2005.

19.15 Për rrjedhojë, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, vlerësohet se nga ana e magjistratit {...} është kryer shkelja disiplinore e parashikuar nga neni 102/1, shkronja “a” dhe “p” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “*Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë: (a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas Ligjit, nëse magjistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tilla;...[...](p) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi*”.

20. Ndërkohë nga aktet e administruara në funksion të hetimit disiplinor, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka rezultuar se në analizë të përmbajtjes së komunikimit ndërmjet magjistratit {...} dhe personit të infiltuar nga ana e emisionit investigativ “STOP”, rezulton në pamje të parë që z. {...}, duke shfrytëzuar pozicionin e tij të punës si magjistrat pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, garanton jo vetëm personin, i cili është i interesuar për të marrë me qira ambientet në pronësi të tij, por shpjegon se edhe subjekte të tjera avokat apo ekspertë të cilët janë qiramarës në godinën ku ai është pronar “zëre se janë pa qira fare” kjo për shkak dhe të interesimit të vetë gjyqtarit duke i angazhuar në procese të ndryshme gjyqësore, të cilat drejtohen prej tij.

20.1 Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga të dhënat e administruara gjatë hetimit disiplinor është provuar se në tre procese gjyqësore ku prania e ekspertit ka qenë nevojshme për zhvillimin e gjykimit, gjykata (gjyqtari {...}) ka caktuar si ekspert z. {...} i cili është më marrëdhënie qiramarje me bashkëshorten e gjyqtarit {...}, pasi ushtron funksionin në një zyrë të marrë me qira në objektin në bashkëpronësi të gjyqtarit. Rastet e provuara si më poshtë janë:

1. Vendimi nr. 301, datë 14.04.2023 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me gjyqtar z. {...}, që i përket çështjes, me palë paditëse trashëgimtarët e {...}, {...} e {...}, i paditur {...}, me objekt “Detyrimin e palës së paditur ti lirojë dhe dorëzojë paditësit truallin”. Në këtë proces gjyqësor rezulton se është thirrur nga Gjykata eksperti {...}. Gjykata ka disponuar duke vendosur pranimin e padisë; detyrimin e palës paditëse të lirojë e dorëzojë paditësave dhe trashëgimtarëve të tjerë truallin.... sipas planvendosjes së aktit të ekspertimit të ekspertit {...}...”

Rezultoni se gjatë kësaj kohe eksperti {...} ka qenë në marrëdhënie qiraje me znj. {...} {...}, bashkëshorte e magjistratit {...}.

2. Vendimi nr. 558, datë 06.07.2023 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me gjyqtar z. {...}, që i përket çështjes, me palë paditëse {...}, i paditur {...}, me objekt “Njohje pronar me parashkrim fitues pa titull mbi pasurinë”. Në këtë proces gjyqësor rezulton se është



thirrur nga Gjykata eksperti {...}. Gjykata ka disponuar duke vendosur pranimin pjesërisht të padisë; Njohjen e pronësisë me parashkrim fitues.... sipas planvendosjes në aktin e ekspertimit të ekspertit topograf {...}...”

Rezulton se gjatë kësaj kohe eksperti {...} ka qenë në marrëdhënie qiraje me znj. {...} {...}, bashkëshorte e magjistratit {...}.

3. Vendimi nr. 7, datë 11.01.2023 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me gjyqtar z. {...}, që i përket çështjes, me palë kërkuese {...}, person i tretë “Bashkia Selenicë”. Në këtë proces gjyqësor rezulton se është thirrur nga Gjykata eksperti {...}. (sipas procesverbalit të datës 19.09.2022)

Gjykata ka disponuar duke vendosur: Pranimin e kërkesës; Vërtetimin e faktit juridik...Me planvendosje dhe kufijtë sipas aktit të ekspertimit të ekspertit topograf {...}...”

Rezulton se gjatë kësaj kohe eksperti {...} ka qenë në marrëdhënie qiraje me znj. {...} {...}, bashkëshorte e magjistratit {...}.

20.2 Kodi i Procedurës Civile në lidhje me caktimin e ekspertit, në nenin 224/a ka parashikuar: “Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose të artit, gjykata mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë. Ekspertët zgjidhen nga një regjistër elektronik i personave të licensuar, i cili administrohet dhe publikohet nga Ministria e Drejtësisë, përveç kur janë kushtet e parashikuara në nenin 224/d, pika 2, të këtij Kodi. Ekspertët caktohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod”. Neni 224/d “Regjistri elektronik i ekspertëve” pikat 1 dhe 2 parashikojnë se: “1. Ministria e Drejtësisë krijon, administron dhe vë në dispozicion për publikun një regjistër elektronik për ekspertët. Ky regjistër ndahet në seksione të ndryshme, duke grupuar ekspertët, sipas fushave të tyre të ekspertizës dhe vendit ku ata punojnë. 2. Gjyqtari cakton një ekspert jashtë regjistrit elektronik, vetëm kur, për nevoja të procesit, eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre”.

20.2.1 Në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë<sup>9</sup>, referuar Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr. 10619, datë 19.10.2018 “Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të regjistrit elektronik për ekspertët” të ndryshuar, është publikuar Regjistri Elektronik i Ekspertëve dhe nga kërkimi në këtë regjistër nuk figuron emri i ekspertit {...} “Topograf në projektim”. Për rrjedhojë, jo vetëm që gjyqtari {...} duke shfrytëzuar pozicionin e magjistratit dhe Vendimimarrjen e tij në një proces gjyqësor ka ndikuar duke caktuar ekspertin që ai kishte interes, por nga ana tjetër i ka sjellë dhe përfitime ekspertit {...} në konflikt të hapur interesi, nisur dhe nga fakti se ky ekspert nuk figuron në listën e ekspertëve pjesë e regjistrit elektronik të publikuar nga Ministria e Drejtësisë, regjistër në të cilin duhet të referohet gjyqtari në caktimin e një eksperti në një çështje gjyqësore.

---

<sup>9</sup><https://ëëë.drejtësia.gov.al/regjistri-elektronik-i-ekspertëve>

20.3 Ndërsa lidhur me proceset gjyqësore të gjykuara nga gjyqtari {...}, ku sipas Ligjit kërkohet caktimi kryesisht i avokatit, nga provat e administruara gjatë hetimit disiplinor ka rezultuar se janë thirrur kryesisht avokatë të cilët kanë qenë në marrëdhënie qirramarje “zyra me qira” me bashkëshorten e gjyqtarit {...}, i cili është dhe bashkëpronar në këto ambiente të dhëna me qira. Konkretisht si më poshtë:

1. Në çështjen që i përket Vendimit nr. 310, datë 23.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.
2. Në çështjen që i përket Vendimit nr. 34, datë 16.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.
3. Në çështjen që i përket Vendimit nr. 473, datë 21.11.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.
4. Në çështjen që i përket Vendimit nr. 135, datë 02.04.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.
5. Në çështjen që i përket Vendimit nr. 230, datë 31.05.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.
6. Në çështjen që i përket Vendimit nr. 493, datë 14.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.
7. Në çështjen që i përket Vendimit nr. 544, datë 12.05.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.
8. Në çështjen që i përket Vendimit nr. 3, datë 02.05.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.
9. Në çështjen që i përket Vendimit nr. 350, datë 13.10.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.
10. Në çështjen që i përket Vendimit nr. 50100-02733-61-2021, datë 13.10.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.
11. Në çështjen që i përket Vendimit nr. 50100-02496-61-2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.
12. Në çështjen gjyqësore me nr. 52005-00357-61-2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është caktuar kryesisht avokati {...}.

20.4 Referuar informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, lidhur me listën e avokatëve për tu caktuar kryesisht, për periudhën 2022-2023, rezulton një numër prej 31 avokatësh pjesë përbërëse e kësaj liste. Për rrjedhojë, jo vetëm që gjyqtari {...}, duke shfrytëzuar pozicionin e magjistratit dhe Vendimmarrjen e tij në një proces gjyqësor ka ndikuar duke i përzgjedhur kryesisht ato avokatë që përbëjnë interes për të, duke ju sjellë përfitime avokatëve të cituar më lart në konflikt të hapur interesi, si dhe duke marrë për bazë dhe faktin se këto avokat janë njëkohësisht edhe subjekte qiramarrëse në pasurinë e magjistratit {...} dhe bashkëshortes së tij.

20.5 Për rrjedhojë, provohet kryerja e shkeljes disiplinore parashikuar nga neni 103 shkronja “b” e Ligjit nr. 96/2016, ku parashikohet: Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit

janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë: ...[...]... b) përdorimi i statusit të magjistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët.

21. Për sa i përket shkeljes tjetër të dyshuar disiplinore për të cilën ka filluar hetimi disiplinor të parashikuar nga neni 103, shkronja “a” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në rastin konkret konstatohet se provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e saj.

21.1 Në interpretim të nenit 103, shkronja “a” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, paraprakisht vlerësohet që shkelja disiplinore të jetë konsumuar në rastin e hetuar kërkon: (i) të provohet që magjistrati të jetë në kushtet e papajtueshmërisë me funksionin për shkak të qënies anëtar në një parti politike apo pjesëmarrja në veprimtari politike apo kryerjen e çdo veprimtarie politike (ii) që magjistrati të administrojë, të drejtojë ose të ushtrojë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit; të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit; të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, nëse shoqëria ka fitime ose të mira nga kontratat publike, në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në fuqi; të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar, për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar.

22. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në analizë të çështjes lidhur me kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, thekson se në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk parashikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë se cilat shkelje disiplinore janë të lehta, të rënda apo shumë të rënda. Në përmbajtje të neneve 106 -111 të Ligjit nr. 96/2016, që japin përshkrimin e masave disiplinore janë parashikuar konceptet e shkeljes së lehtë, të rëndë dhe shumë të rëndë, në raport me secilën masë disiplinore. Në të njëjtën kohë neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës parashikon konceptin e shkeljeve shumë të rënda për shkarkimin e gjyqtarit nga detyra. Në këto kushte arrihet në përfundimin se për të arritur në një përfundim të qartë në lidhje me rëndësinë e shkeljes disiplinore duhet të bëhet rast pas rasti një analizë juridike dhe faktike e kriteve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore të parashikuara nga neni 115 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor.

23. Në nenin 115, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohen në mënyrë jo shteruese, si kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore: (a) lloji dhe rrethanat e shkeljes; (b) shkalla

e fajësisë dhe motivi; (c) pasojat e shkeljes; (ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit; (d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; (dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen; (e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; (ë) sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; (f) sjellja e magjistratit gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; (g) çdo çështje tjetër që konsiderohet e rëndësishme.

23.1 Në analizë të kriterit “mbi llojin dhe rrethanat e shkeljes” sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rezulton se nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor, janë ndërmarrë veprime që përbëjnë një mospërbushje të rregullt të detyrës, në shkelje të rregullave të papajtueshëmërisë, në kushtet e konfliktit të interesit si dhe në përdorimin e statusit të magjistratit me qëllim krijimin e përfitimeve për të tjerët si dhe në shkelje të parimit të garantimit të besimit të publikut tek drejtësia. Këto shkelje të konstatuara nuk lidhen me veprimtarinë e tij profesionale dhe që mund të jenë të rëndësishme vetëm me qëllim vlerësimin etik dhe profesional të saj, por janë të natyrës që magjistrati duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore

23.2 Në analizë të kriterit të “shkallës së fajësisë dhe motivi”, paraprakisht vlerësohet se faji si një element i përgjegjësisë disiplinore duke qenë se ka të bëjë me qëndrimin subjektiv të magjistratit ndaj kryerjes së shkeljes disiplinore si dhe pasojave të ardhura në lidhje me këtë shkelje disiplinore, nuk mund të provohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me prova dokumentare. Për të përcaktuar praninë (*ekzistencën*) dhe formën (*shkallën*) e fajit duhet të analizohen rast pas rasti rrethanat të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e shkeljes disiplinore. Për këtë arsye për të përcaktuar anën subjektive të kryerjes së shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor janë analizuar rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore.

23.2.1 Inspektori i Lartë i Drejtësisë argumenton se nga të dhënat e administruara gjatë hetimit disiplinor, provohet se veprimet e magjistratit {...} janë kryer me dashje, pasi ka pranuar faktin se në video është ai që komunikon me të panjohurin për dhënien me qira të zyrës që ai dhe bashkëshortja e tij e kanë në bashkëpronësi. Ndërkohë që në deklarime vetë gjyqtari është shprehur se dhe sikur të isha i veshur me pelerinën e gjyqtarit përsëri do të interesohesha për t’i dhënë me qira pronat që ai ka në bashkëpronësi me bashkëshorten e tij. Veprime të cilat janë faktuar në mënyrë të vazhduar pasi në 15 raste të identifikuara gjyqtari ka ndikuar duke caktuar kryesisht në procese gjyqësore ekspertë apo avokatë të cilët ushtronin funksionin e në zyra të marrë me qira në objektin në bashkëpronësi të gjyqtarit.

23.3 Ndërsa në analizë të kriterit “pasojat e shkeljes” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë thekson se rezulton se si pasojë e shkeljes disiplinore të kryer nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor është cënuar

prestigji i figurës së gjyqtarit, si dhe është cenuar besimi i publikut të drejtësisë. Besimi i publikut nuk është nocion i papërkufizuar, por ai gjen mbështetje te vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magistratëve, sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

23.3.1 Në nenin 3, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar se sjellja e magistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien e sigurimin e drejtësisë në shoqëri ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike.

23.3.2 Sjellja e gjyqtarëve në kontekstin profesional është shumë e rëndësishme. Referuar parimeve të Bangalore, cënimi edhe vetëm i parimeve të etikës, në marrëdhëniet e punës apo edhe jashtë saj mund të përbëjë shkak për cenimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Gjatë këtij procesi zbatohet testi i vëzhgimit të sjelljes së tyre duke marrë në konsideratë faktin se si do të perceptohet një sjellje e caktuar nga një individ i arsyeshem, i paanshem dhe i mirëinformuar i shoqërisë dhe a e zvogëlon ky perceptim respektin për vetë gjyqtarin apo gjithë gjyqësorin? Referuar “*teorisë së dukjes*”, drejtësia jo vetëm duhet të bëhet por edhe duhet të shihet. Në këtë kuptim, vlerësohet se ka rëndësi se çfarë veprimesh ka bërë një gjyqtar në përmbushje të detyrës së tij, por është e rëndësishme gjithashtu të vlerësohet se çfarë shoqëria mendon. Në këtë kuptim, sjellje të caktuara të gjyqtarit, konsiderohen si cenim i parimit të besimit të publikut tek drejtësia. Jo vetëm kaq, por kjo ngjarje duke qenë mediatike ndikon negativisht në syrin e publikut dhe krijon idenë e një gjyqësori jo të pavarur, të anshëm dhe të paragjykuar duke cënuar kështu rëndë besimin e publikut tek gjyqësori.

24. Në analizë të kriterit “të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magistratit”, rezulton se magistrati {...} ka një vjetërsi në detyrë afërsisht prej 24 vitesh si gjyqtar, tregues ky i njohjes shumë të mirë të tij mbi rolin e ushtrimit të detyrës me përgjegjësi në mënyrë korrekte, me objektivitet e në mënyrë të paanshme. Pavarësisht eksperiencës së gjatë të tij në detyrë, gjyqtari ka dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të.

24.1 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nga të dhënat e marra nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor ka konkluduar se:

- Ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë me Vendimin nr. 159, datë 16.07.2004, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” ndaj gjyqtarit {...}, për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës.

- Me Vendimin nr. 464 datë 13.10.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pranimi i pjesshëm i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke vendosur masën disiplinore të “Vërejtjes publike” ndaj magjistratit z. {...} me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

24.2 Në mbështetje të nenit 33, pika 6, të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, si dhe nenit 150, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar rezulton se masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim” dhënë me Vendimin nr. 159, datë 16.07.2004, të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe masa disiplinore “Vërejtje publike” dhënë me Vendimin nr. 464 datë 13.10.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë shuar. Në këtë kuadër rezulton se magjistrati {...}, nuk ka masë disiplinore për një shkelje disiplinore të mëparshme në fuqi.

24.3 Nga të dhënat e paraqitura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor rezulton se: (i) Me Vendimin nr. 95/22 datë 02.10.2015 të Këshillit të Lartë Gjyqësor gjyqtari {...} ka marrë vlerësimin përfundimtar “Mirë” për periudhën 01.01.2007-31.12.2009. Lidhur me këtë vlerësim rezulton se gjyqtari është vlerësuar “Mirë” në dy kritere vlerësimi, përkatësisht në kriteret: “Grupi i aftësive profesionale të përgjithshme organizuese dhe zbatuese”; “Grupi i aftësive të kapacitetit njerëzor dhe angazhimi profesional”; dhe vlerësimi “Pranueshëm” në kriterin “Grupi i aftësive profesionale juridike dhe teknike”; (ii) Me Vendimin nr. 352/5 datë 05.07.2013 të Këshillit të Lartë Gjyqësor gjyqtari {...} ka marrë vlerësimin përfundimtar “Mirë” për periudhën 2005-2006. Lidhur me këtë vlerësim rezulton se gjyqtari është vlerësuar “Mirë” në tre kritere vlerësimi, përkatësisht në kriteret: “Grupi i aftësive profesionale juridike dhe teknike”; “Grupi i aftësive organizuese dhe zbatuese”; “Grupi i aftësive të angazhimit profesional”; dhe vlerësimi “Shumë mirë” në kriterin “Grupi i aftësive profesionale të përgjithshme”.

24.3.1 Në të njëjtën kohë, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë lidhur me ankesa të paraqitura ndaj magjistratit {...}, ka rezultuar se 30 ankesa janë në fazë shqyrtimi fillestar, 14 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, për 6 ankesa është vendosur arkivim pas verifikimit ndërsa 1 ankesë është në fazë verifikimi.

25. Në analizë të kriterit “masa e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor rezulton se mund të passjell përhapjen e kësaj sjellje e cila në vetvete cënon dinjitetin dhe reputacionin e magjistratit.

26. Në analizë të kriterit “sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit” apo “sjellja e magjistratit gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij”, rezulton se sjellja e magjistratit ka qenë bashkëpunuese. Magjistrati ka paraqitur të nënshkruar aktin e njoftimit të hetimit disiplinor, sikundërse i është kërkuar nga inspektorët e ngarkuar me hetimin, ndërsa ka paraqitur dhe parashtresë

me shkrim të shoqëruar me aktet përkatëse me qëllim justifikimin e shkeljes disiplinore për të cilën kishte filluar hetimi.

27. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore; (ii) kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit me dashje direkte; (iii) mosrespektimi në vazhdimësi nga ana e magjistratit i rregullave për t'u shmangur nga konflikti i interesit privat në raport me detyrën e tij zyrtare; (iv) përdorimi i statusit të magjistratit me qëllim përfitimi të personave të tretë, nëpërmjet ndikimit për t'i thirrur kryesisht në procese gjyqësore avokatët/ekspertët të cilët janë me qira në pronën në bashkëpronësi të gjyqtarit subjekt hetimit disiplinor; (v) si pasojë e veprimit/mosveprimit të magjistratit subjekt hetimi disiplinor është cënuar prestigji i figurës së gjyqtarit, si dhe është cënuar besimi i publikut të drejtësisë; (vi) magjistrati ka një vjetërsi në detyrë prej 24 vitesh si gjyqtar, tregues ky i njohjes shumë të mirë të tij mbi rolin e ushtrimit të detyrës me pavarësi, paanësi dhe integritet; (vii) magjistrati ka marrë dhe më parë masa disiplinore për një shkelje disiplinore të mëparshme në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit, po ato për shkak të kalimit të afatit ligjor nga koha kur janë marrë, janë shuar dhe si të tilla nuk janë në fuqi; (viii) sjelljes së magjistratit gjatë hetimit disiplinor, arrihet në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit {...}, që përbëjnë shkelje disiplinore, parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “a”, “p”, neni 103 shkronja “b” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në rastin konkret përbëjnë “*Shkelje shumë të rëndë disiplinore*”.

28. Në analizë të çështjes lidhur me “llojin e masës së disiplinore” paraprakisht vlerësohet se Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i referohet sanksionit disiplinor me termin “*masë disiplinore*”. Sipas parashikimeve të nenit 105 të Ligjit, konstatohet se kjo dispozitë në përputhje me parimin e ligjshmërisë, i cili kërkon që masa disiplinore të përcaktohet nga ligji, parashikon detyrimin për përzgjedhjen e masave disiplinore të parashikuara nga kjo dispozitë në një listë prej 6 masash (*nga më e lehta te më e rënda*), me qëllim që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, në zbatim të parimit të drejtësisë, objektivitetit, individualizimit dhe proporcionalitetit.

28.1 Qëllimi thelbësor i masës disiplinore është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklarimit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit për shkak të shkeljes disiplinore që ai ka kryer dhe marrja e masave aktive për edukimin e magjistratit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Në të njëjtën kohë masa disiplinore që caktohet ndaj magjistratit përmbush edhe dy qëllime parandaluese: (i) parandalimin e posaçëm, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe (ii) parandalimin e përgjithshëm, në kuptimin që magjistratët e tjerë kuptojnë që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

29. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar i referohet sanksionit disiplinor me termin “*masë disiplinore*”, nga e cila kuptohet se qëllimi thelbësor i masës është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklarimit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit për shkak të shkeljes disiplinore që ai ka kryer dhe marrja e masave aktive për përmirësimin/edukimin e magjistratit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

29.1 Ndërkohë, në rastin kur shkelja disiplinore e kryer është aq e rëndë sa e bën magjistratin të papërshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar funksionin e tij, atëherë masa disiplinore nuk mund të luajë më rol edukues. Në këtë rast, masa disiplinore merr përsipër të mbrojë interesin publik, duke larguar nga detyra magjistratin dhe duke u kthyer kështu në masë me natyrë të pastër ndëshkuese ndaj tij. Kjo masë disiplinore përcaktohet pikësisht në nenin 140, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit gjyqtari shkarkohet nga detyra kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Në të njëjtën kohë kjo masë parashikohet edhe në nenin 111 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku parashikohet përgjegjësia disiplinore e magjistratit për një shkelje shumë të rëndë, që e bën atë të papërshtatshëm ose të padenjë për të vazhduar ushtrimin e funksionit. Papërshtatshmëria ose padenjësia e magjistratit për të vazhduar funksionin mund të ketë si shkak: (i) dënimin e magjistratit për kryerjen e një krimi; (ii) paaftësinë e rëndë dhe dukshme të magjistratit; ose (iii) sjellje të kryer me pakujdesi të rëndë, që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor.

30. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka dalë në bazë dhe në zbatim të nenit 140 të Kushtetutës, ka përcaktuar se cilat veprimet/mosveprime të magjistratëve përbëjnë shkelje disiplinore, të cilat përbëjnë dhe shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj gjyqtarit. Në të njëjtën kohë, në ligj nuk parashikohen në mënyrë të drejtpërdrejt se cilat shkelje disiplinore janë të lehta, të rënda apo shumë të rënda, por për të arritur në këtë konkluzion në lidhje me rëndësinë e shkeljes disiplinore duhet të bëhet rast pas rasti një analizë juridike dhe faktike e kriterëve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore të parashikuara nga neni 115 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor.

31. Në analizë të parashikimeve të nenit 105<sup>10</sup>, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet se kjo dispozitë në përputhje me parimin e ligjshmërisë, i cili kërkon që masa disiplinore të përcaktohet nga ligji parashikon detyrimin për përzgjedhjen e masave disiplinore të parashikuara nga kjo dispozitë, si dhe në të njëjtën kohë, kjo dispozitë parashikon një listë

---

<sup>10</sup> Masat Disiplinore



prej 6 masash disiplinore për të mundësuar zbatimin e parimit të drejtësisë, objektivitetit, individualizimit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer.

32. Në rastin konkret për sa është analizuar më sipër, është arritur në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit {...} të cilat përbëjnë shkelje disiplinore sipas nenit 102, pika 1, shkronjat “a”, “p”, neni 103 shkronja “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në bazë të kriterëve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore të parashikuara nga neni 115<sup>11</sup> i Ligjit nr. 96/2016, përbëjnë “*Shkelje shumë të rëndë disiplinore*”.

33. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se për shkelje shumë të rënda disiplinore mund të jepet masa disiplinore “*Pezullimi si masë disiplinore*” apo “*Shkarkimi*”<sup>12</sup>. Të dyja këto masa mund të jepen për shkelje shumë të rënda, por vetëm me dallimin lidhur me papërshtatshmërinë apo padenjësinë e magjistratit për të vazhduar funksionin e tij, si pasojë e kryerjes së një shkelje disiplinore për shkak të paaftësisë së rëndë dhe të dukshme dhe që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor.

34. Në analizë të këtyre parashikimeve rezulton se aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit kërkojnë një analizë të hollësishme, mbi vlerësimin e ekzistencës së tyre. Ky proces vlerësimi lidhet me një sërë elementesh që kanë të bëjnë me ato shkelje të dispozitave ligjore të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj. Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e Ligjit të shkelur, me pasojat e ardhura, apo që mund të vinin nga shkelja, me frekuencën e shkeljes, kohëzgjatjen e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe me qëndrimin subjektiv që mban magjistrati kundrejt saj dhe pasojës së ardhur. Të gjitha këto parime gjejnë zbatim në dispozitat e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

35. Kushtetuta ka parashikuar në disa norma detyrimin e gjyqtarëve për të respektuar me përpikmëri Kushtetutën, ligjet dhe për të ruajtur paanësinë e figurën e pastër në funksion të dhënies së një drejtësie bindëse. Nëse konstatohen raste të inkriminimit të gjyqtarëve, akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e gjyqtarit ose pamjaftueshmëri profesionale, organet përgjegjëse duhet të mbajnë qëndrimet e duhura deri në shkarkimin nga detyra të gjyqtarit<sup>13</sup>.

---

<sup>11</sup> Kriteret për caktimin e masës disiplinore

<sup>12</sup> Neni 105, pika 1, gërma “dh”

<sup>13</sup> Vendimi Nr. 11/2004, i Gjykatës Kushtetuese

36. Duke mbajtur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore së magjistratit, në përputhje me parimin e drejtësisë, objektivitetit, individualizimit të masës disiplinore si dhe proporcionalitetit, në vlerësim të: (i) të gjitha fakteve të konstatuara dhe analizës ligjore të tyre; (ii) llojin dhe rrethanat e shkeljes; (iii) formën dhe shkallën e fajësisë nëpërmjet kryerjes së shkeljes disiplinore me dashje; (iv) kryerjes së shkeljes në mënyrë vazhduese më shumë se një herë; (v) vjetërsisë së magjistratit në sistemin e drejtësisë dhe të dhënat mbi aftësitë profesionale të tij; (vi) sjellja e magjistratit gjatë hetimit disiplinor; (viii) faktit se masat më të lehta disiplinore janë të papërshtatshme për rrethanat e shkeljes disiplinore, si dhe faktin që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën “*Shkelje shumë të rëndë disiplinore*”; provohet se magjistrati {...}, në veprimet dhe mosveprimet e tij ka kryer shkelje të rënda profesionale.

37. Për sa sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë duke mbajtur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore së magjistratit, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e parashikuar nga ligji dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e Ligjit; duke u bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore; individualizimit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, përsëritja e shkeljeve disiplinore, paraprakisht vlerëson se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit {...}, parashikohen si shkelje disiplinore nga neni 102, pika 1, shkronjat “a”, “p”, neni 103 shkronja “b”, e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të cilat bazuar në nenin 111 të Ligjit nr. 96/2016 përbëjnë “*Shkelje shumë të rëndë disiplinore*”, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, shkelje për të cilat duhet të jepet masa disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”.

38. Në analizë të identifikimit të elementeve juridik dhe faktik që justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraprakisht vlerëson se në mbështetje të nenit 134, pika 1, shkronja “a”, 138, 142, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke qenë se në rastin konkret: (i) rezulton e provuar kryerja e shkeljeve disiplinore nga ana e magjistratit {...}; (ii) ekzistojnë elementët faktikë dhe juridikë të cilët provojnë ekzistencën e shkeljeve disiplinore, si dhe nuk diktojnë mbylljen e hetimit disiplinor, (përfshij fakti për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 103, shkronja “a” e Ligjit 96/2016 “Për Statusin”); (iii) ekzistojnë elementët faktikë dhe juridikë të cilët provojnë përgjegjësinë disiplinore të magjistratit subjekt hetimi disiplinor; arrihet në konkluzionin se Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet të fillojë procedimin disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “a”, “p”, neni 103 shkronja “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

39. Sa sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me Vendimin nr. 161/32 prot., datë 15.02.2024, ka vendosur :

- a) *Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “a”, “p”, neni 103 shkronjat “a” dhe “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*
- b) *Mbylljen e hetimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 103 shkronja “a” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*
- c) *Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “a”, “p”, neni 103, shkronja “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*
- d) *Propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “dh”, dhe neni 111 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*
- e) *Njoftimin e magjistratit {...} me raportin e hetimit dhe me Vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi përfundimin e hetimit disiplinor dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij për shkeljen disiplinore të përcaktuar në pikën 3 të këtij Vendimi.*
- f) *Dërgimin e raportit të hetimit disiplinor së bashku me dosjen hetimore pranë institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

## **II. PROCEDURA E ZHVILLUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

40. Pas depozitimit të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me vendimin nr. 92, datë 20.02.2024, Këshilli ka vendosur të caktojë si relator të çështjes, z. Ridvan Hado, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Disiplinor. Vendimi për caktimin e relatorit të çështjes i është njoftuar palëve të procedimit disiplinor përkatësisht Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit, brenda afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 141 të Ligjit për Statusin.

41. Me vendimin nr. 96, datë 23.02.2024, mbi propozimin e relatorit të çështjes, Këshilli ka vendosur kalimin e çështjes në seancë dëgjimore, duke caktuar datën 13 mars 2024, ora 11.00, si datë të zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, duke njoftuar rregullisht palët në zbatim të parashikimeve të nenit 138 të Ligjit për Statusin.

41.1 Bashkë me njoftimin për caktimin e seancës dëgjimore, magjistratit i janë njoftuar dhe të drejtat e tij gjatë procedimit disiplinor, sipas përcaktimeve të nenit 141, pika 2, gërma a) të ligjit.

42. Magjistrati z. {...} ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht është me status i pezulluar, bazuar në vendimin e datës 13.03.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me të cilin ka vendosur : “1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.....”. Nga verifikimi i faqes elektronike të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezulton se vendimi ende nuk është zbardhur.

43. Pas shqyrtimit të kësaj rrethane faktike, në seancën dëgjimore të datës 09.04.2024, relatori i çështjes i parashtroi Këshillit të Lartë Gjyqësor, propozimin për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit {...}, deri në marrjen formë të prerë të vendimeve të dhëna nga organi kompetent i rivlerësimit Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

44.1 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përfaqësuesi i tij, parashtroi pretendimet duke kërkuar pranimin e kërkesës, ndërsa magjistrati {...} kërkoi pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj tij, pasi do të ushtronte të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **III. LIGJI I ZBATUESHËM**

45. Në nenin 97, pika 3 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj.”

46. Në aspektin e pezullimit të një procedure administrative individuale, Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 66 të tij, jep kuptimin e çështjes paraprake si parakusht për zgjidhjen e procedurës së filluar nga një organ publik. Sipas këtij neni: “1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë. ...”.

47. Edhe në Ligjin për Statusin trajtohet çështja e pezullimit të procedurës administrative, vetëm në aspektin e ndërvarësisë së procedimit disiplinor nga rezultatet e procedurave të filluara nga organe të tjera, pra në rastet e zhvillimit të një hetim penal ose të një procesi gjyqësor penal, administrativ, ose civil, ku është palë dhe magjistrati nën hetim ose procedim disiplinor dhe shkelja disiplinore e dyshuar ose e atribuar atij lidhet me të njëjtat

fakte. Konkretisht, në nenin 145 të Ligjit, titulluar “Pezullimi i procedimit disiplinor”, përcaktohet se: “Parashikimet ligjore gjatë procedimit disiplinor të nenit 126, të këtij ligji, do të aplikohen për aq sa gjejnë zbatim”. Nga ana tjetër, në nenin 126, të këtij ligji, titulluar “Pezullimi i hetimeve”<sup>14</sup>, parashikohet se: “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil: a) në të cilat, njëra nga palët është magjistrati; b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi. 2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent. .... 6. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohehet.”

48. Neni 179/b, pika 7, e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë<sup>15</sup>, ka parashikuar se: “7. Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. ...”

49. Më tej, neni 164 i Ligjit për Statusin, në dispozitat e tij kalimtare, përcakton se: “1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: ...b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.”

#### **IV. VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

50. Referuar të dhënave faktike të rastit rezulton se magjistrati z. {...}, në të njëjtën kohë, është nën dy procedime disiplinore, ku ai i filluar më herët (procesi i rivlerësimit kalimtar sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës dhe të Ligjit nr. 84/2016) tashmë ka përfunduar dhe organi kompetent disiplinor ka marrë masën disiplinore “Shkarkim nga detyra”, vendim ky që mund të jetë objekt i kontrollit nga organi më i lartë i rivlerësimit, mbi ankimin e magjistratit. Ndërkohë, procedimi i dytë disiplinor ndaj magjistratit (sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin) është aktualisht për shqyrtim përpara organit të përhershëm disiplinor të gjyqtarëve, pra Këshillit të Lartë Gjyqësor.

51. Sipas parashikimeve ligjore në fuqi, vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për “Shkarkimin nga detyra” të magjistratëve, përbëjnë masë disiplinore në kuptim të legjislacionit në fuqi, ç’ka përcaktohet shprehimisht në nenin 58, pika 1 (Masat disiplinore)<sup>16</sup>, sikundër edhe në nenin 61 (Shkarkimi nga detyra)<sup>17</sup>, të Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Vendimi i këtij organi kushtetues për dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, është një vendim, pasojat juridike e të cilit fillojnë menjëherë, duke përbërë shkak për

<sup>14</sup> Ndryshuar me Ligjin nr. 48/2019

<sup>15</sup> Shtuar me Ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016

<sup>16</sup> “1. Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit: ...; c) shkarkimin nga detyra....”.

<sup>17</sup> “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: ...”.

ndërprerjen e menjëhershme të ushtrimit të detyrës nga gjyqtari ose prokurori subjekt rivlerësimi, ndaj të cilit ai është marrë<sup>18</sup>. Nga ana tjetër, Ligji për Statusin, kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit, në përputhje me Ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, e konsideron si parakusht për vijimin e gëzimit nga gjyqtarët në detyrë, të statusit të magjistratit të parashikuar në këtë ligj.

52. Në rastin konkret, ky proces, i natyrës disiplinore, për magjistratin subjekt të këtij procedimi disiplinor, aktualisht ka përfunduar përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ku me vendimin përkatës, organi disiplinor kompetent për kontrollin e ligjshmërisë së pasurisë, të pastërtisë së figurës dhe pasjes së aftësive minimale profesionale për periudhën e rivlerësimit sipas pikës 5, neni 179/b, të Kushtetutës dhe Ligjit nr. 84/2016, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, masë e cila sipas ligjit krijon si efekt të menjëhershëm pezullimin nga detyra të magjistratit deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes së rivlerësimit nga organi kontrollues, Kolegji i Posaçëm i Apelit, si Dhoma e Dytë e Gjykatës Kushtetuese, në rast të ankimit të vendimit të masës disiplinore.

53. Fakti që masa disiplinore “Shkarkim nga detyra” nuk është vendosur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin, nuk mund të çojë në mos ekzistencën e kësaj mase disiplinore dhe as në anashkalimin e saj. Me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me ndryshimet e vitit 2016, parashikoi ngritjen e sistemit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, një proces ky i jashtëzakonshëm dhe tranzitor, që kryhet nga organet e pavarura kushtetuese dhe që ka për qëllim kontrollin e ligjshmërisë së pasurisë, të pastërtisë së figurës dhe të pasjes së aftësive minimale profesionale. Në kuadër të këtij procesi ligjor, Kushtetuta dhe ligji i dalë në zbatim të saj (Ligji 84/2016), kanë konsideruar që, në raport me objektin e rivlerësimit kalimtar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vepron si organ disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

54. Nisur nga kjo, vendimmarrja e këtij organi disiplinor, e dhënë brenda kompetencave të tij, nuk mund të anashkalohej dhe të mos merret në konsideratë, përfshirë edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “...22. I gjithë procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, edhe pse është një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, është ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, duke parashikuar institucionet që do të kryejnë këtë proces, kompetencat e tyre, si edhe mënyrën e zgjedhjes

---

<sup>18</sup> Neni 62, i Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se: “1. Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet ex lege nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apeliteve. Gjatë periudhës së pezullimit atij i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës. 2. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje. ...”.

së anëtarëve dhe garancitë që ata gëzojnë. Qëllimi i përcaktimit të kompetencave të këtyre organeve në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutë do të thotë se asnjë institucion nuk mund të marrë këto kompetenca apo t'i anashkalojë ato". Nga ana tjetër, në hipotezën që ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk ushtrohet ankim nga magjistrati apo lihet në fuqi nga organi më i lartë kontrollues, kjo masë disiplinore sjell si pasojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}.

55. Ligjërish, procesi i rivlerësimit kalimtar dhe procedimi disiplinor sipas Ligjit për Statusin, janë dy procese të pavarura nga njëri tjetri, që zhvillohen nga organe të ndryshme, të pavarura dhe sipas procedurave jo të njëjta, rrethana këto që, pavarësisht faktit që ato zhvillohen ndaj të njëjtit magjistrat, bëjnë të pamundur bashkimin e tyre në një procedim të vetëm. Ndërkohë këto procese kanë ndikim ndaj njëri tjetrit, duke përcaktuar vijueshmërinë e tyre. Kështu, procesi i rivlerësimit, që është një proces i detyrueshëm për të gjithë gjyqtarët në detyrë (në momentin e miratimit të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016), përcakton vijimin e gëzimit nga ata të statusit të magjistratit sipas Ligjit për Statusin. Nga ana tjetër, moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit passjell mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit, rrethanë kjo që përbën shkak për mbylljen e procedimit disiplinor sipas Ligjit për Statusin, referuar nenit 139, pika 1, shkronja "c"<sup>19</sup> në lidhje me nenin 134, pika 1, shkronja "ç"<sup>20</sup>, nenin 64, pika 1, shkronja "ç"<sup>21</sup> dhe nenin 164, të tij.

56. Vlen të theksohet se masa disiplinore "*Shkarkim nga detyra*", sipas përcaktimeve të ligjit për rivlerësimin kalimtar, pra mbi bazën e një ligji me natyrë kalimtare, nuk mund sanksionohet nga ligjvënësi si një mënyrë e mbarimit të statusit, në dispozitat e nenit 64 të Ligjit për Statusin, por vetëm në dispozitat kalimtare të tij. Konkretisht, është neni 164 të këtij ligji, i cili vendos një urë lidhëse midis dy ligjeve, duke zgjeruar interpretimin e shkronjës "ç", të pikës 1, të nenit 64, dhe duke sanksionuar se statusi i magjistratit mbaron edhe në rastet kur ai shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore sipas ligjit, "*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*". Ndërkohë, e njëjta situatë ndodh edhe në rastin kur procedimi disiplinor sipas Ligjit për Statusin përfundon me dhënien e masës disiplinore "*Shkarkimin nga detyra*", vendim ky që impakton vijimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj atij magjistrati, referuar për këtë jurisprudencës së organeve të rivlerësimit.

57. Ligji për Statusin ka rregulluar edhe pezullimin e procedimit disiplinor në nenin 145, dispozitë kjo që referon në nenin 126 të tij, që bën fjalë për pezullimin e hetimit disiplinor. Në rastin konkret, jemi para një procesi administrativ (procesi i rivlerësimit kalimtar) që

<sup>19</sup> "1. Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: ...; c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat "ç" dhe "d"; ...".

<sup>20</sup> "1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: ...; ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat "b" deri në "ç", të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji...".

<sup>21</sup> "1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: ...; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; ...".

zhvillohet ndaj magjistratit z. {...}, objekti i të cilit është pikërisht verifikimi i kërkesave kushtetuese për vijimin e mbajtjes prej tyre të statusit të magjistratit. Duket sikur rasti në shqyrtim nuk është pikërisht ai për të cilin bën fjalë neni 126, pika 1, i Ligjit për Statusin, kjo sa i përket rrethanës sipas shkronjës “b”, për sa kohë shkelja e dyshuar disiplinore në rastin konkret nuk lidhet me faktet objekt të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj magjistratit. Por, pavarësisht kësaj, duhet thënë sërish se procesi i rivlerësimit kalimtar, si një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, e ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, nuk është një rrethanë pjesë e rregullimeve të përhershme ligjore në Ligjin për Statusin lidhur me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve, kjo në mënyrë të vetëkuptueshme për shkak të përkohshmërisë së zbatimit të tyre.

58. Nga ana tjetër, po ashtu, siç mund të konstatohet, dualiteti i mundshëm i procedimeve disiplinore ndaj magjistratëve për periudhën e përkohshme nuk ka gjetur trajtim, përmes ndonjë rregullimi specifik, as në dispozitat tranzitore të Ligjit për Statusin (përveç sa parashikohet në nenin 164 të tij). Ndërkohë, në kuptim dhe zbatim të këtij ligji, magjistrati nuk mund të jetë në të njëjtën kohë nën disa hetime ose procedime disiplinore të veçanta, kjo për shkak të ndikimit që ato kanë lidhur me sanksionin disiplinor sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 115, të Ligjit për Statusin. Kështu, në rastin kur magjistrati është nën hetim disiplinor, ndërsa ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër disiplinore, atëherë objekti i hetimit disiplinor duhet të shtohet ose ndryshohet<sup>22</sup> ose procedimet hetimore duhet të bashkohen kur ato iu referohen të njëjtave fakte<sup>23</sup>. Po ashtu, edhe në rastin kur magjistrati është nën procedim disiplinor, ndërsa ngrihen dyshime të arsyeshme se mund të jetë kryer një shkelje tjetër disiplinore, atëherë procedimi disiplinor ndërpritet dhe çështja i kalon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për kryerjen e hetimeve të mëtejshme dhe, në eventualitet, mund të shtohet ose ndryshohet objekti i procedimit disiplinor, si dhe, nëse është rasti i panevojshmërisë së hetimeve të mëtejshme, procedimi disiplinor vazhdon duke u shtuar ose

---

<sup>22</sup> Neni 125 i Ligjit për Statusin, titulluar “Shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit”, parashikon se: “1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit, në zbatim të nenit 124 të këtij ligji. 2. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim”.

<sup>23</sup> Neni 128 i Ligjit për Statusin, titulluar “Bashkimi i procedimeve hetimore”, parashikon se: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkon procedimet, në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit magjistrat”.



ndryshuar objekti i tij<sup>24</sup>. Dhe po ashtu, kur magjistrati gjendet nën disa procedime disiplinore që iu referohen të njëjtave fakte, procedimet bashkohen<sup>25</sup>.

59. Pra, ligji bazë për përgjegjësinë disiplinore të magjistratit, tek i cili mbështet qëndrimin e tij dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, lidhur me pamundësinë e pezullimit të procedimit disiplinor, nuk pranon ekzistencën në të njëjtën kohë të disa procedimeve disiplinore ndaj një magjistrati. Ndaj, për zbatimin strikt të këtij ligji (Ligjit për Statusin), do të duhej që të gjitha faktet të atribuuar si shkelje disiplinore magjistratit në fjalë, të shqyrtoheshin në një procedim disiplinor të vetëm. Por një gjë e tillë, sikurse më lart u përmend, është e pamundur ligjërisht pasi, sipas legjislacionit në fuqi, procesi i rivlerësimit kalimtar dhe procedimi disiplinor sipas Ligjit për Statusin, janë dy procese të pavarura nga njëri tjetri, që zhvillohen nga organe të ndryshme, të pavarura dhe sipas procedurave jo të njëjta.

60. Në këto kushte, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se zbatimi i legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve kërkon, nga njëra anë, pranimin e realiteteve kushtetuese, ligjore dhe faktike dhe, nga ana tjetër, adresimin e tyre në mënyrë efektive dhe efikase për qëllimin e zbatimit të saj, pikërisht zbatimin kur është rasti të sanksioneve disiplinore me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së magjistratit në ushtrimin e funksionit në të ardhmen.

61. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se qëllimi i nenit 126, pika 1, të Ligjit për Statusin është dhënia përparësi e proceseve të tjera ligjore ndaj magjistratit në raport me procedimin disiplinor, duke kushtëzuar këtë të fundit me përfundimet e tyre, sa kohë ato kanë lidhje dhe ndikim të drejtpërdrejtë në këtë të fundit. Dhe në rastin konkret është e dukshme se mënyra e përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj z. {...}, ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe kushtëzon vijimin e procedimit disiplinor ndaj tij, në harmoni dhe me përcaktimin e nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative, Kod i cili është i detyrueshëm për t'u

---

<sup>24</sup> Neni 136 i Ligjit për Statusin, titulluar “Dërgimi i çështjes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, parashikon se: “1. Nëse gjatë procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër, atëherë: a) kërkon të ndërpresë procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit; b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve. 2. Këshilli mund të dërgojë çështjen te Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në rastet e parashikuara në nenin 144 të këtij ligji”; si dhe neni 144, i këtij ligji, titulluar “Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor”, parashikon se: “1. Kur Këshilli çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, ka të drejtë: a) të urdhërojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me këtë ligj, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit njëmuajor; b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim. 2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vepron sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 136, të këtij ligji”.

<sup>25</sup> Neni 140 i Ligjit për Statusin, titulluar “Bashkimi i procedimeve disiplinore”, parashikon se: “1. Kur Këshilli konstaton që procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit magjistrat, mund të vendosë bashkimin e procedimeve. ...”.

zbatuar nga Këshilli (neni 97, pika 3, i Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar), duke përligjur pezullimin e këtij procedimi disiplinor.

62. Në këto kushte, ndërsa aktualisht është vënë në diskutim dhe është pranuar ekzistenca e një shkakut kushtetues për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, në kushtet kur ai është “*Shkarkuar nga detyra*” nga organi disiplinor i rivlerësimit kalimtar dhe çështja e rivlerësimit mund të shkojë për shqyrtim përpara organit më të lartë të rivlerësimit, Këshilli vlerëson se një rrethanë e tillë përbën shkak që, bazuar në nenin 145 të Ligjit për Statusin dhe nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative, të vendoset pezullimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, deri në përfundim të çështjes së rivlerësimit, pasi mbajtja ose jo e statusit të magjistratit nga ai, në kuptim të Ligjit për Statusin, përbën parakusht për shqyrtimin në themel të procedimit disiplinor ndaj tij, në kushtet kur shkarkimi nga detyra e magjistratit, sikurse më lart u parashtrua, përbën një nga rastet e mbylljes së procedimit disiplinor. Nga ana tjetër, marrja nga Kolegji i Posaçëm i Apelit të një vendimi për prishjen e vendimit të shkarkimit nga detyra të magjistratit, në eventualitetin e ankimit të tij, janë kushtet ligjore për rënien e shkakut të pezullimit të procedurës së shqyrtimit disiplinor dhe rifillimin e saj.

63. Këshilli vlerëson se pikërisht pezullimi i procedimit disiplinor, siç paraqitet në rastin konkret, nuk pengon shqyrtimin e tij në një kohë të mëvonshme (me rënien e shkakut të pezullimit), nëse nuk do të verifikohet rasti i mbylljes së tij (mbarimi i statusit të magjistratit për z. {...} për shkak të “*shkarkimit nga detyra*” me vendim përfundimtar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar). Pra, ky pezullim nuk sjell asnjë pasojë negative për procedimin disiplinor dhe as pengon shqyrtimin e tij nëse plotësohet kërkesa e ligjës, pikërisht qartësimi i rrethanës të vijimit të mbajtjes nga gjyqtari i proceduar disiplinarisht të statusit të magjistratit. Nga ana tjetër, vlen të përmendet se vijimi i shqyrtimit të këtij procedimi disiplinor, sikurse kërkohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, edhe në supozimin e pranimit të kërkesës së tij për ekzistencën e shkeljes disiplinore dhe vendosjes së sanksionit të propozuar ndaj magjistratit, nuk krijon asnjë impakt në këtë rast dhe, aq më pak, impaktin e pritshëm ligjor. Në këtë rast, impakti në realitet, është se tashmë magjistrati është nën një efekt pezullues, pikërisht, për shkak të vendimit të organit të rivlerësimit dhe ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 62).

64. Lidhur me koherencën në qëndrimet e tij, vlen të përmendet se në procedime disiplinore të mëparshme<sup>26</sup>, ku magjistratët janë vënë para përgjegjësisë disiplinore dhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është kërkuar “*Shkarkimi nga detyra*” për shkak të vërtetimit të një shkakut të përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë<sup>27</sup>, pikërisht “*dënimi me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi*”, Këshilli ka operuar me shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe sanksionimin e magjistratëve me këtë masë. Në këto raste, magjistratët kanë qenë në proces

<sup>26</sup> Procedimet disiplinore ndaj magjistratëve {...}, {...} dhe {...}.

<sup>27</sup> Sipas nenit 140 të Kushtetutës: “2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: ...; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. ...”.

rivlerësimi, por ky proces për ata nuk kishte përfunduar. E përveç kësaj, ajo çka është më e rëndësishme, Këshilli ka vlerësuar se vërtetimi në ato raste i ekzistencës së një shkakut kushtetues për “*Shkarkimin nga detyra*” të magjistratëve, nuk mund të pengonte zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj tyre. Ngritja në rang kushtetues të këtij shkakut dhe parashikimi nga vetë Kushtetuta edhe të sanksionit disiplinor imponon pa ekuivok ushtrimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të funksionit kushtetues disiplinor<sup>28</sup>, përderisa kushtetutëbërësi i ka dhënë të njëjtën rëndësi shkaqeve dhe sanksioneve disiplinore të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë, e cila në këto raste është e zbatueshme dhe drejtpërdrejtë. Ndërkohë, rasti në shqyrtim nuk është i tillë.

65. Po ashtu, vlen të përmendet edhe se në procedime disiplinore të mëparshme<sup>29</sup>, ku magjistratët janë vënë para përgjegjësisë disiplinore dhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është kërkuar vendosja e një sanksioni disiplinor për shkak të vërtetimit të një shkakut të përcaktuar nga Ligji për Statusin, Këshilli ka operuar me shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe, kur ka qenë rasti, me vendosjen e sanksioneve disiplinore sipas ligjit, ndërsa magjistratët në këto raste kanë qenë në proces rivlerësimi, por ky proces për ata nuk kishte përfunduar, pra ata vijonin të ushtronin detyrën. Ndërkohë, rasti në shqyrtim, sikurse më lart u parashtrua, nuk është i tillë dhe Këshilli ka operuar me pezullimin e procedimeve disiplinore deri në përfundim të procesit të rivlerësimit ndaj magjistratëve subjekt të procedimit<sup>30</sup>.

66. Së fundi, referuar pikës 6, të nenit 126, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “6. *Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet*”, në lidhje me përcaktimin e nenit 145, të këtij ligji, sipas të cilit parashikimet e nenit 126, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim edhe për procedimet disiplinore, Këshilli vëren se ligji iu ka kufizuar subjekteve të procedimit disiplinor të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj vendimit të pezullimit të procedimit disiplinor, pra ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim.

## **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenin 145, në lidhje me nenin 126, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, i Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

## **V E N D O S I:**

<sup>28</sup> Sipas nenit 147/a të Kushtetutës: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: ...; b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve; ...”.

<sup>29</sup> Procedimet disiplinore ndaj magjistratëve {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

<sup>30</sup> Procedimet disiplinore ndaj magjistratëve {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

1. Pezullimin e procedimit disiplinor nr. 3/2024 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të datës 13.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Kundër këtij vendimi ligji nuk lejon ankim.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet subjektit të procedimit disiplinor, magjistratit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**